



## INFORMACIONI SIPAS NENIT 13 DHE 14 (GDPR)

### Informacioni sipas Nenit 13 dhe 14 të Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR)

Institutit Goethe e.V., Oskar-von-Miller-Ring 18, 80333 München, në vijim e gjeni dhe me emërtimin GI, mbledh dhe përpunon të dhënat tuaja personale (në vijim “të dhënat”) sipas udhëzimeve të renditura më poshtë.

#### **PËRGJEGJËSI**

Goethe-Institut e.V.  
Oskar-von-Miller-Ring 18  
80333 München  
Telefoni: +49 89 15921-0  
[info@goethe.de](mailto:info@goethe.de)  
[www.goethe.de](http://www.goethe.de)

### **1. Qëllimi dhe baza ligjore për përpunimin e të dhënave**

Institutit Goethe zhvillon projekte në kuadër të udhëzimeve kombëtare për mbështetjen e AMIF-it. Të dhënat personale të pjesëmarrësve përpunohen nga Institutit Goethe në kontekstin e organizimit dhe koordinimit të projektit (p.sh. gjatë regjistrimit tuaj nëpër aktivitete). Gjithashtu Institutit Goethe është i detyruar që në kuadër të menaxhimit dhe faturimit të granteve të dhëna nga AMIF-i, të raportojë mbi të dhënat personale të pjesëmarrësve. Baza ligjore për trajtimin është neni 6 paragrafi 1, nënparagrafi b) i Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR), si dhe neni 6 paragrafi 1, nënparagrafi f) i GDPR-së. Institutit Goethe do të kontaktojë pjesëmarrësit me qëllim vlerësimin e masave të projektit dhe për të ofruar informacione rreth ofertave të tjera të projektit përmes email-it. Baza ligjore për këtë është neni 6 paragrafi 1, nënparagrafi f) i GDPR-së.

### **2. Lloji i të dhënave të ruajtura**

Tek subjektet e grupit të synuar, parimisht merren dhe ruhen të dhënat personale në vijim:

Mbiemri, emri, data e lindjes, gjinia, vendi i origjinës, kombësia, vendi i planifikuar i mbërritjes në Gjermani, lloji dhe numri i mjetit të identifikimit, vendi i planifikuar i qëndrimit në Gjermani, aryeja e qëndrimit në Gjermani, adresa e email-it.

### **3. Ruajtja dhe fshirja e të dhënave**

Dokumentat e projektit ruhen për një hark kohor prej 10 vitesh duke nisur nga 31 dhjetori i vitit në të cilin përfundon projekti (§ 31 Udhëzimet e financimit të AMIF). Pas kalimit të këtij afati kohor, vijon fshirja e të dhënave.

[www.goethe.de](http://www.goethe.de)



Kofinanziert von der  
Europäischen Union

**GOETHE  
INSTITUT**

Sprache. Kultur. Deutschland.

## INFORMACION SIPAS NENIT 13 DHE 14 (GDPR)



### Informacioni sipas Nenit 13 dhe 14 të Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR)

#### 4. Të drejtat për mbrojtjen e të dhënave

Çdo "subjekti" i lind e drejta mbi përpunimin e të dhënave, mbi bazën e një kërkesë me shkrim dhe nëse plotësohen kushtet përkatëse në vijim:

- Informacion mbi përpunimin e të dhënave personale (neni 15 GDPR)
- Korrigjimi i të dhënave të gabuara personale (neni 16 i GDPR)
- Fshirja e të dhënave të panevojshme (neni 17 GDPR)
- Kufizimi i përpunimit të të dhënave personale (neni 18 GDPR)
- Kundërshtimi ndaj përpunimit të të dhënave (neni 21 i GDPR).

**Kundërshtimi:** Ju keni të drejtë të kundërshtoni në çdo kohë dhe për arsye të situatës tuaj të veçantë, përpunimin e të dhënave tuaja bazuar në bazën ligjore të nenit 6 para. 1 lit. f) GDPR. Ne nuk do të vijojmë më me përpunimin e të dhënave tuaja, në rast se vërtetohet baza të ligjshme bindëse ose kur përpunimi i të dhënave i shërben qëllimit të ushtrimit ose mbrojtjes së pretendimeve ligjore.

**Lidhur me përpunimin e të dhënave në bazë të pëlqimit sipas nenit 6 (1) (a) të GDPR, vlen: E drejta e revokimit në rast pëlqimi.**

Nëse në kuadër të lidhjes së kontratës tuaj keni dhënë pëlqimin tuaj për përpunimin e të dhënave personale, ju mund ta revokoni këtë pëlqim në çdo kohë. Ligjshmëria e veprimeve të kryera në bazë të miratimit deri në momentin e revokimit të përpunimit të të dhënave, nuk do të ndikohet nga ky revokim.

#### 5. Detajet e kontaktit për "personat e prekur"

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me grumbullimin, përpunimin ose përdorimin e të dhënave tuaja personale, informacionin, korrigjimin, kufizimin e përpunimit ose fshirjen e të dhënave, si dhe revokimin e ndonjë pëlqimi të dhënë ose kundërshtim ndaj një përdorimi të caktuar të të dhënave dhe të drejtën për përcjelljen e tyre, ju lutemi kontaktoni përgjegjësën e kompanisë tonë për mbrojtjen e të dhënave:

Përgjegjësi për mbrojtjen e të dhënave  
Goethe-Institut e.V.  
Oskar-von-Miller-Ring 18, 80333 München  
E-Mail: [datenschutz@goethe.de](mailto:datenschutz@goethe.de)

#### ANKESË PRANË AUTORITETIT MBIKËQYRËS

Ju gjithashtu keni të drejtën të parashtroni një ankesë pranë autoritetit kompetent mbikëqyrës për mbrojtjen e të dhënave.

Ai është Komisioneri Federal për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Lirinë e Informacionit, Graurheindorfer Straße 153, 53117 Bonn. Ju gjithashtu mund të dorëzoni ankesën tuaj pranë çdo autoriteti tjetër për mbrojtjen e të dhënave. Kjo ankesë do t'i përcillet autoritetit kompetent mbikëqyrës përgjegjës.

[www.goethe.de](http://www.goethe.de)



Kofinanziert von der  
Europäischen Union

**GOETHE  
INSTITUT**

Sprache. Kultur. Deutschland.